

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Isa Kelmendi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B. B., nga ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E. B.-S., avokate në ..., kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit D. H. punëtor i së njëjtës, për kompensim dëmi nga baza e auto përgjegjësisë, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, Ac.nr.3553/2014 datë 24.9.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me 10.4.2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ac.nr.3553/2014 datë 24.9.2018.

A r s y e t i m i

Me pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, Ac.nr.3553/2014 datë 24.9.2018, është vërtetuar pika I e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore, Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2502/2011 datë 7.3.2014, në pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit material për fitimin e humbur (rentën) dhe shpenzimet e mjekimit dhe pika III e dispozitivit të njëjtë aktgjykim lidhur me kamatën e gjykuar dhe shpenzimet e procedurës, me çka ankesa e të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, për këtë pjesë të kërkesëpadisë është refuzuar si e pabazuar. Me pjesën II të dispozitivit është aprovuar pjesërisht ankesa e të paditurës dhe është ndryshuar pika I e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, në pjesën e kërkesëpadisë për kompensimin e dëmi jo material për dhimbjet e përjetuara fizike, frikën, shëmtimin trupor dhe zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, dhe është gjykuar si në vijim: është detyruar e paditura që paditësit në emër të kompensimit të dëmit jo material të shkaktuar në aksidentin e

trafikut me datë 30.7.2011, nga baza e auto përgjegjësisë, t'ia paguajë shumat si në vijim: për dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 4.500 €, për frikën e përjetuar shumë prej 3.000 €, për dhimbjet shpirtërore për shëmtim trupor shumë prej 3.000 €, për zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 12.000 €. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit për kompensim të dëmit jo material në emër të dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar, dhimbjeve shpirtërore për shkak të shëmtimit trupor dhe zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, mbi shumat e gjykuara është refuzuar si i pabazuar. Me pjesën III të dispozitivit ka mbetur e pashqyrtuar pika II e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi me kohë ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ashtu që për pjesën refuzuese të kërkesëpadisë të mbetet në fuqi aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë.

E paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve ka paraqitur përgjigje në revizion, me propozim që revizioni të refuzohet si i pabazuar, ndërsa të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë, ngase shumat e gjykuara janë në harmoni me praktikat gjyqësore dhe si të tilla paraqesin satisfaksion për paditësin.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi aktgjykimin e goditur sipas nenit 215 të LPK, dhe gjeti se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se në fatkeqësinë e komunikacionit më datë 30.7.2011, paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, të cilat si pasojë tek i njëjti kanë shkaktuar dhimbje fizike, frikë, shëmtim trupor, zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 30 %, zvogëlim të aktivitetit punës në shkallën prej 40%, ka pësuar humbje për shkak të zvogëlimit të aftësisë punuese dhe i janë shkaktuar shpenzime për mjekim. Gjatë shqyrtimit kryesor e paditura nuk e ka kundërshtuar bazën e kërkesëpadisë por vetëm lartësinë e shumës së kërkuar me kërkesëpadi, mirëpo pas pranimit të super ekspertizës, e paditura paditësit i ka ofruar ofertën për dëmin material e jomaterial në shumë prej 10.000 €, ndërsa lidhur me rentën i ka ofruar shumë prej 12.000 €, gjithsejtë shumë e përgjithshme prej 22.000 €.

Në bazë të kësaj gjendje të vërtetuar faktike gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke konsideruar se lartësia e aprovuar në emër të shpërblimit të dëmit jo material e material, është shpërblim real dhe objektiv, pastaj ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të asaj gjykate.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën sipas ankesës pjesërisht ka pranuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke konstatuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejt ka zbatuar të drejtën materiale në pjesën që ka të bëjë me kompensimin e dëmit për rentën e arritur për periudhën 30.7.2011 deri më 28.2.2014, për 40% të zvogëlimit të aftësisë punuese, t'ia paguaj paditësit shumën prej 3.883,67 €, ndërsa për periudhën prej 1.3.2014 e deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore për çdo muaj shumën prej 127 €, e cila duhet të paguhet më së largu deri më datën 5 të muajit vijues për muajin paraprak, si dhe për pjesën refuzuese të kërkesëpadiës dhe kamatën e shpenzimet e procedurës, ndërsa lidhur me dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, shëmtimin trupor dhe zvogëlimin e aktivitetit jetësor ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale, për të cilën arsye ka ndryshuar aktgjykimin e ankimuar dhe ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Pretendimin e revizionit se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitës së nenit 182 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate është i pabazuar, ngase dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i qartë, nuk është në kundërshtim me arsyetimin dhe përmban arsye të mjaftueshme për gjykim të drejtë e të ligjshëm. Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimin e kundërshtuar e shqyrton konform dispozitës ligjore nga neni 215 të LPK, ndërsa nuk gjeti shkelje të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar dhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate mbi

gjendjen e tillë faktike gjykata e shkallës së dytë drejtë ka zbatuar dispozitat e nenit 200 të LMD -ës lidhur me nenin 323 të LPK -ës, përkitazi me caktimin e lartësisë së dëmit jo material për dhimbjet fizike në shumën prej 4500 €, për frikën e përjetuar shumën prej 3.000 €, për shëmtim trupor shumën prej 3000 € dhe zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 12.000 €, ngase, këto shuma të gjykuara janë caktuar në bazë të ekspertizës mjekësore nga ekspertët Dr. A. K. -neurokirurg dhe Dr. sci. M. Sh.- psikiatër. Gjatë caktimit të lartësisë së shpërblimit për format e caktuara të dëmit jo material, gjykata sipas nenit 200 të LMD duhet të kujdeset për rëndësinë e të mirës së dëmtuar dhe qëllimit të cilit i shërben ai shpërblim, por edhe për atë që me te mos të favorizojnë synimet të cilat nuk janë në përputhje me natyrën e shpërblimit të tillë të dëmit jo material dhe qëllimit shoqëror. Duke pasur parasysh kriteret e parapara me këtë dispozitë, rëndësinë e vlerave të dëmtuara të paditësit, shkallën e intensitetit të dhimbjeve trupore, frikës së përjetuar, shëmtimit trupor dhe zvogëlimit të aktivitetit jetësor në shkallën prej 30% dhe praktikën e gjertanishme të gjykatave në Kosovë, shuma e caktuar e shpërblimit të dëmit paditësit nga ana e gjykatës së shkallës së dytë sipas vlerësimit të kësaj Gjykate është reale dhe në përputhje me kriteret e parapara sipas kësaj dispozite, për të cilën arsye gjykata e shkallës së dytë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, kur aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ndryshuar ashtu që ka gjykuar shumat e cekura si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Pretendimin e paditësit të cekur në revizion se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale kur ka aprovuar ankesën e të paditurës dhe ka zvogëluar shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, shëmtimin trupor dhe zvogëlimin e aktivitetit jetësor, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase, gjykata e shkallës së dytë me të drejtë ka vlerësuar se përcaktimi i kompensimit në shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së parë nuk përkon me rëndësinë e të mirës së cenuar dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim dhe praktikën gjyqësore, sepse shumat e gjykuara do të ja mundësojnë paditësit plotësimin e nevojave të përditshme duke ja bërë kështu ma të lehtë jetën e tij dhe harruar përjetimet e pakëndueshme të cilën e ka përjetuar si pasojë e lëndimeve të marra nga aksidenti, duke u siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësin dhe duke shmangur qëllimet tjera materiale. Andaj nga arsyet e cekura , Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se janë të pabazuara pretendimet e paditësit se gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të gabuar ka zbatuar nenin 190 dhe nenin 200 par. 2 të LMD -ës.

Gjykata Supreme e Kosovës shqyrtoi pretendimin e paditësit të cekur në revizion se ai është kryefamiljar dhe nga puna të cilën e ka bërë para aksidentit ka siguruar ekzistencën për veti dhe familje, të cilën punë më nuk është në gjendje ta bëjë, si pasojë e lëndimeve të marra në aksidentin e komunikacionit, por një pretendim i tillë nuk ndikoi që kjo Gjykatë të vendosë ndryshe, ngase, gjykatat e instancës më të ulët kanë aprovuar kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e rentës së arritur për zvogëlim të aftësisë punuese dhe ka përcaktuar rentën për periudhën e ardhshme, ndërsa këtë pjesë të aktgjykimit paditësi nuk e ka goditur me revizion.

Nga sa u tha më lart, e në pajtim me nenin 222 të LPK -ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.87/2019 datë 10.4.2019

Kryetare e kolegjit,

Emine Kaçiku